



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KESHILLI I MINISTRAVE  
Komisioni i Prokurimit Publik



100 Vjet Pavarësi

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr.1.1000 Tiranë, E-mail: Kpp\_info@kpp.gov.al, Tel/Fax: 04 2281 860

Nr. 954/prot  
5

Tiranë, më 02.10. 2012

L e n d a: Vendim

Drejtuar: **MINISTRISË SË EKONOMISË TREGTISË DHE ENERGJETIKËS**

TIRANË

Agjencisë së Prokurimit Publik

TIRANË

Operatorit ekonomik "Kotorri - SL" sh.p.k.

Pallati Destaxhei, Fshati Qesarakë (pranë teleferikut), Komuna Dajt

TIRANË

**Baza Ligjore:** Ligji nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet" i ndryshuar, neni 24/1 e vijues, VKM Nr. 469, datë 16.06.2010 "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e shqyrtimit të ankesave ndaj procedurave të koncesionit apo të vendimeve për përjashtim nga këto procedura", dhe "Për një ndryshim në vendimin nr.27", datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve",

Komisioni i Prokurimit Publik i mbledhur në prani të Kryetarit dhe të anëtarëve, Z. Elton Lula, Z. Klodi Beja, Znj. Besa Ombashi, mori në shqyrtim ankesën nr. 954, të datës 07.08.2012, të paraqitur nga operatori ekonomik "Kotorri - SL" sh.p.k., për procedurën koncesionare me objekt: "Për dhënien me koncesion të Hec Malind", zhvilluar nga autoriteti kontraktues Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në datë 20.07.2012.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e operatorit ekonomik "Kotorri - SL" sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se subjekti ankimues rezultoi ofertues në këtë procedurë koncesionare dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në Ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për Koncesionet" i ndryshuar, neni 24/1 e vijues, VKM nr. 469, datë 16.06.2010 "Për miratimin e rregullores

për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e shqyrtimit të ankesave ndaj procedurave të koncesionit apo të vendimeve për përjashtim nga këto procedura” dhe për një ndryshim në VKM nr. 27, datë 19.01.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”.

Në këto kushte, ankesa i nënshtrohet juridiksionit administrativ dhe shqyrtimi i saj është kompetencë lëndore e Komisionit të Prokurimit Publik.

Nga shqyrtimi i ankesës, dokumenteve që Komisioni i Prokurimit Publik disponon në lidhje me këtë procedurë koncesionare, dokumentet e paraqitura nga operatori ekonomik ankimues dhe Autoriteti Kontraktues, u konstatua si vijon:

Në datë 20.07.2012 është zhvilluar procedura koncesionare me objekt: “Për dhënien me koncesion të Hec Malind”, nga Autoriteti Kontraktues, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Në garën koncesionare kanë marrë pjesë 2 (dy) operatorë ekonomikë dhe konkretisht:

1) Shoqëria “Kotorri - SL” sh.p.k.;

2) Bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Al-Can Hydropower” sh.p.k. & “Fybek” sh.p.k.

Në datë 01.08.2012 (marrë në dorëzim nga operatori ekonomik ankimues në datë 02.08.2012) autoriteti kontraktues me anë të shkresës nr. 10573/25 prot., ka njoftuar operatorin ekonomik “Kotorri - SL” sh.p.k., për skualifikimin e tij nga kjo procedurë koncesionare, si dhe kualifikimin dhe klasifikimin në vend të parë të bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Al-Can Hydropower” sh.p.k. & “Fybek” sh.p.k., me 101 pikë.

Sipas njoftimit të autoritetit kontraktues, shoqëria “Kotorri - SL” sh.p.k., është skualifikuar nga kjo procedurë koncesionare me arsyetimin se:

*“Dokumentacioni financiar është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dspk, por nga përmbajtja e këtij dokumenti rezulton, se sipas bilancit të vitit 2011 (viti i fundit ushtrimor i paraqitur) të shoqërisë “Kotorri - SL” sh.p.k., kapitali i saj është më pak se 20 % e vlerës së investimit. Në aneksin II, pika ii, të dspk është përcaktuar si kriter financiar për kualifikimin e ofertës, që kapitali i vitit të fundit ushtrimor duhet të jetë të paktën sa 20 % e vlerës së investimit të përgjithshëm (pa tvsh) të propozuar nga ofertuesi. Mosplotësimi i këtij kriteri nga shoqëria “Kotorri – SL” sh.p.k., është shkaku i skualifikimit të ofertës së paraqitur”.*

Në datë 07.08.2012, operatori ekonomik “Kotorri - SL” sh.p.k., ka paraqitur ankim pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Me anë të ankimit të paraqitur pranë KPP-së, ankimesi kundërshton skualifikimin e tij nga kjo procedurë koncesionare, si dhe kundërshton kualifikimin e bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Al-Can Hydropower” sh.p.k. & “Fybek” sh.p.k.

Më konkretisht në ankesën e paraqitur pranë KPP-së ankimesi pretendon se:

1) Në lidhje me skualifikimin e tij nga kjo procedurë, ankimesi pretendon se në zbatim të Ligjit “Për shoqëritë Tregëtare”, Ligjit “Për Kontabilitetin”, Ligjit “Për Tatimin mbi të ardhurat dhe të pasqyrave financiare” bashkëlidhur bilancit, si dhe Ligjit “Për QKR”, miratimi i xhiros dhe kapitalit të vitit ushtrimor bëhet “de jure” dhe “de facto” në datë 31 Korrik të vitit pasardhës. Pavarësisht faktit që në bilancin e vitit 2011 kjo shumë kapitali nuk është e njëjtë me miratimin që i është bërë në muajin Korrik dhe që “de facto” është

pasqyruar në ekstraktin e shoqërisë të dorëzuar së bashku me ofertën në datën e zhvillimit të procedurës, ankimuesi pretendon se ky dokument është anashkaluar nga KVO-ja.

Ankimuesi bën me dije se shoqëria “Kotorri - SL” sh.p.k., ka bërë rritje kapitali dhe shuma e kapitalit të vetë shoqërisë e kalon shumën prej 20 % të kërkuar mbi investimin e propozuar, sipas dspk. Bazuar në faktet e mësipërme, ankimuesi pretendon se është skualifikuar pa të drejtë.

2) Në lidhje me kualifikimin e bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Al-Can Hydropower” sh.p.k. & “Fybek” sh.p.k., në këtë procedurë, ankimuesi pretendon se:

Pasi shoqëria “Kotorri - SL” sh.p.k., u vu në dijeni të proces verbalit nr. 1 të datës 20.07.2012 të KVO-së, ka vënë re disa mangësi në ofertën e bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Al-Can Hydropower” sh.p.k. & “Fybek” sh.p.k., dhe konkretisht:

a) Ankimuesi pretendon se nga të dy anëtarët e bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Al-Can Hydropower” sh.p.k. & “Fybek” sh.p.k., nuk është paraqitur statuti dhe akti i themelimit, që kërkohet në dspk.

b) Ky bashkim shoqërisht nuk ka paraqitur preventivin dhe njëkohësisht grafikun e punimeve, të cilat i bashkëlidhen formularit të ofertës.

c) Referuar ofertës së paraqitur nga ky bashkim shoqërisht, dhe konkretisht vlerës së investimit të propozuar dhe fuqisë së propozuar, rezulton se nuk është plotësuar kriteri i kërkuar në dspk, ku përcaktohet se vlera e projektit të jetë jo më e vogël se 500.000 euro/mw. Nga shqyrtimi i ofertës së dhënë nga ana e bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Al-Can Hydropower” sh.p.k. & “Fybek” sh.p.k., kjo vlerë është më e vogël e për rrjedhojë kriteri nuk përmbushet.

d) Ky bashkim shoqërisht nuk ka paraqitur oponencën e kryer nga AKBN, duke qenë se shoqëria “Al-Can Hydropower” sh.p.k., ka qenë pjesë e këtij vlerësimi. Në lidhje me këtë fakt, ankimuesi pretendon se në vlerësimin juridik mund të interpretohet në rregull që bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Al-Can Hydropower” sh.p.k. & “Fybek” sh.p.k., kanë paraqitur një oponencë tjetër duke vlerësuar projektin e ri, por në vlerësimin teknik ankimuesi pretendon se vlerësimi i projektit nga oponenca e AKBN-së mund të bjerë ndesh me vlerësimin e ri të projektit, pasi sasia e ujit është vlerësuar më e madhe, rreth 60 % më shumë se realiteti. Ankimuesi pretendon se moduli i rrjedhjes së ujit për ofertën e bashkimit të mësipërm të shoqërive, mund të jetë tek shifrat 30 – 35 l/sek/km<sup>2</sup>, ndërkohë që moduli i ujit për këtë zonë mund të luhatet në analogji nga të gjitha drejtimet gjeografike të zonës nga 18-24 l/sek/km<sup>2</sup>, duke mbartur edhe një risk hidrologjik. Referuar të dhënave teknike të ofruara nga bashkimi i mësipërm i shoqërive, ankimuesi pretendon se këto të dhëna janë tepër të larta dhe praktikisht të paarrtshme. Ankimuesi pretendon se referuar të dhënave hidrologjike të prurjeve mesatare dhe të dhënave të volumit të ujit në kurbën e qëndrueshmërisë, bashkimi i shoqërive “Al-Can Hydropower” sh.p.k. & “Fybek” sh.p.k., me ofertën e paraqitur ka dalë përtej të dhënave teorike referuar prurjes 100 ditore të kurbës së qëndrueshmërisë, duke tejkaluar prurjen rreth shifrës 30 ditore dhe praktikisht kanë dalë jashtë termave të referencës. Si pasojë e veprimit të mësipërm volumi i ujit mund të jetë rritur mbi 60 % të sasisë, nga e cila del edhe prodhimi mbi 25.9 milion kwh. Gjithashtu ankimuesi pretendon se referuar krahasimit të orëve të punës kundrejt treguesit të fuqisë së tij (tejkalohe mbi 7400 orë) çka do të thotë që kjo ofertë duke futur edhe këtë tregues, ka një fryrje prej të paktën 11.500.000 kwh më shumë).

Ankimuesi pretendon se, nëse projektet do të krahasohen kundrejt parametrave të mësipërm ashtu siç janë të përshkuara edhe në dspk, oferta e bashkimit të shoqërive “Al-Can Hydropower” sh.p.k. & “Fybek” sh.p.k., duhet të bjerë poshtë për të dhëna të rreme.

Përsa mësipër, operatori ekonomik ankimues, me anë të ankesës së paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, kërkon kualifikimin e shoqërisë “Kotorri - SL” sh.p.k., si dhe skualifikimin e bashkimit të shoqërive “Al-Can Hydropower” sh.p.k. & “Fybek” sh.p.k., nga kjo procedure konkurrimi.

### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pasi dëgjoi relatorët Z. Klodi Beja, Znj. Besa Ombashi dhe Z. Edi Spaho, pas shqyrtimit të ankesës dhe të dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktues,

### **Arsyetoi:**

Në lidhje me pretendimin e parë, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Kotorri - SL” sh.p.k., nga kjo procedurë koncesionare, pas shqyrtimit të ankesës, dokumenteve të paraqitura nga ankimuesi, dokumenteve të paraqitura nga Autoriteti Kontraktues, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se:

Nga shqyrtimi i dokumentave standarde të procedurës konkurruese, Aneksi II “*Kërkesat ekonomike/financiare për kualifikim*”, rezulton se nga Autoriteti kontraktues është kërkuar kriteri:

*“Ofertuesi duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të konkurimit dhe mban përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë, siç parashikohet apo nënkuptohet në Kushtet e Përgjithshme dhe të veçanta të Kontratës.*

*Ofertuesi duhet të provojë që:*

*ii) Kapitali i vet (totali i aktivitetit minus totalin e detyrimeve) i vitit të fundit ushtrimor të jetë të paktën sa 20 % e vlerës së investimit të përgjithshëm (pa TVSH) të propozuar nga ofertuesi”.*

Nga shqyrtimi i formularit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Kotorri - SL” sh.p.k., rezulton se vlera e investimit të propozuar nga kjo shoqëri është në shumën 245.071.000 lekë (pa TVSH).

Gjithashtu nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “Kotorri - SL” sh.p.k., rezulton se për të plotësuar këtë kriter kualifikimi janë paraqitur:

- a) Pasqyrat financiare të shoqërisë “Kotorri - SL” sh.p.k., për vitin 2010 dhe vitin 2011;
- b) Kopje të ekstraktit historik të shoqërisë “Kotorri - SL” sh.p.k., lëshuar nga QKR në datë 20.07.2012, nga ku rezulton se në datë 18.07.2012 është depozituar vendimi i Asamblesë së Ortakëve datë 16.07.2012 për miratimin e raportit të ekspertit kontabël për zmadhimin e kapitalit dhe vlera e kapitalit të ri të kësaj shoqërie është 51.200.000 lekë.

Duke qenë se:

(i) kriteri i kërkuar nga autoriteti kontraktor përcakton se ofertuesi duhet të provojë që kapitali i vet i vitit të fundit ushtrimor të jetë të paktën sa 20 % e vlerës së investimit të përgjithshëm (pa TVSH) të propozuar nga ofertuesi;

(ii) vlera e investimit të propozuar nga kjo shoqëri është në shumën 245.071.000 lekë (pa TVSH) dhe në përputhje me kriterin e mësipërm kapitali i kësaj shoqërie duhej të ishte jo më pak se 20 % e vlerës prej 245.071.000 lekë ose jo më pak se 49.014.200 lekë;

(iii) Nga shqyrtimi i ekstraktit historik të shoqërisë “Kotorri - SL” sh.p.k., rezulton se kapitali i saj është në shumën 51.200.000 lekë;

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktues në Aneksin II “Kërkesat ekonomike/financiare për kualifikim”, është plotësuar nga operatori ekonomik “Kotorri - SL” sh.p.k.

Përsa mësipër, pretendimi i parë i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Në lidhje me pretendimin e dytë të operatorit ekonomik ankimues, për kualifikimin e bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Al-Can Hydropower” sh.p.k. & “Fybek” sh.p.k., në këtë procedurë, pas shqyrtimit të ankesës, dokumenteve të paraqitura nga ankimuesi, dokumenteve të paraqitura nga Autoriteti Kontraktues, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se:

Në lidhje me pretendimin 2/a të ankimuesit KPP gjykon se:

Në Aneksin I të DSPK, pika “Bashkimi i Shoqërive”, nga autoriteti kontraktues është përcaktuar se:

*“Përpara dorëzimit të ofertës bashkimi i përkohshëm duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së secilit anëtar dhe elementët konkretë, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi të përkohshëm. Vullneti për të hyrë në marrëveshje të bashkimit të përkohshëm të shoqërive duhet të jetë i shprehur qartë me vendim të organit vendimarrës të të gjitha shoqërive pjesëmarrëse në kontratën e bashkimit të përkohshëm. Për të vërtetuar se cili është organi vendimarrës në këtë bashkim të përkohshëm shoqëror, duhet të paraqitet statuti aktual i secilës prej shoqërive pjesëmarrëse në këtë bashkim të përkohshëm. Pas krijimit të bashkimit të përkohshëm të shoqërive anëtarët e këtij bashkimi caktojnë me prokurë, përfaqësuesin e tyre, si për dorëzimin e ofertës dhe për lidhjen e kontratës, në rast se shpallet fitues. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në autoritetin e bashkimit të përkohshëm të shoqërive”.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga anëtarët e bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Al-Can Hydropower” sh.p.k. & “Fybek” sh.p.k., si dhe nga verifikimi i procesverbalit të hapjes së ofertave të mbajtur nga autoriteti kontraktues në datë 20.07.2012, rezulton se asnjë nga anëtarët e këtij bashkimi operatorësh nuk e ka paraqitur statutin e vet, siç është përcaktuar në kërkesat e dspk.

Përsa mësipër, pretendimi 2/a i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Në lidhje me pretendimin 2/b të ankimuesit KPP gjykon se:

Nga shqyrtimi i dokumentave standarde të procedurës konkurruese rezulton se autoriteti kontraktues ka përcaktuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas ofertës së paraqitur duhet të paraqesin edhe një plan biznesi ku të përfshihen: preventivi dhe grafiku i punimeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ana e bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Al-Can Hydropower” sh.p.k. & “Fybek” sh.p.k., rezulton se janë paraqitur:

a) oferta;

b) Plani i biznesit ku janë të përfshirë preventivi dhe grafiku i punimeve për të tre Hec-et e propozuara nga ky bashkim shoqërisht;

Bazuar, në dokumentacionin e mësipërm të paraqitur nga bashkimi i shoqërive, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteri i kërkuar nga autoriteti kontraktues është përmbushur.

Përsa mësipër, pretendimi 2/b i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

Në lidhje me pretendimin 2/c të ankimesit KPP gjykon se:

Në aneksin II të dokumentave standarde të procedurës konkurruese, “Kërkesat ekonomike/financiare”, pika 2, autoriteti kontraktues ka përcaktuar:

*“Për efekt të llogaritjes së vlerës së investimit për përmbushjen e kapacitetit ekonomik dhe financiar, vlera e investimit do të llogaritet mbi bazën e preventivave të paraqitura (projekti teknik dhe plani i biznesit), por në bazë të kostove minimale rajonale, asnjëherë nuk do të pranohet që:*

*1) për projektet nga deri në 15 MW vlera e investimit për MW fuqi të instaluar të jetë më e vogël se 500.000 Euro”*

*2) ....”.*

Gjithashtu në dshp, “Strukturën e Planit të Biznesit”, autoriteti kontraktues ka përcaktuar se:

*“Monedha e Ofertës:*

*Të gjitha vlerat duhet të kuotohen në Monedhën Shqiptare (lek), duke përfshirë edhe tatimet që zbatohen, por pa përfshirë TVSH”.*

Nga shqyrtimi i ofertës teknike dhe ekonomike të propozuar nga bashkimi i shoqërive “Al-Can Hydropower” sh.p.k. & “Fybek” sh.p.k., rezulton se kjo shoqëri ka propozuar një vlerë Investimi prej 378.390.152 lekë me tvsh, (fakt i cili rezulton nga verifikimi i planit të biznesit), si dhe ka propozuar një Fuqi të instaluar prej 5470 KW (5,47 MW). Referuar kësaj oferte, rezulton se vlera e investimit për MW është 57.646.275 lekë ose 419.154 Euro (referuar kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë në datën 20.07.2012 – data e hapjes së ofertave). Duke qenë se projekti i ofruar nga ky bashkim shoqërisht është 5.47 MW, gjykojmë se vlera e investimit prej 419.154 Euro për MW nuk e plotëson kriterin e kërkuar.

Përsa mësipër, pretendimi 2/c i ankimesit qëndron.

Në lidhje me pretendimin 2/d të ankimesit KPP gjykon se:

Së pari oponenti teknike nuk është kriter kualifikimi. Në bazë të Ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006, “Për Koncesionet”, VKM nr. 469, datë 16.06.2010 “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e shqyrtimit të ankesave ndaj procedurave të koncesionit apo të vendimeve për përjashtim nga këto procedura”, dhe “Për një ndryshim në vendimin nr.27”, datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, sqarojmë se për procedurat koncesionare “Propozim i Pakërkuar”, projekti i pakërkuar i paraqitet për oponentin AKBNS-së, ku bëhet miratimi ose jo i projektit me vendim, pra oponenti teknike nuk është pjesë e

procedurës së konkurrimit, por është procedurë e cila realizohet dhe i paraprin procedurës së konkurrimit.

Së dyti, në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se: *“Moduli i rrjedhjes së ujit për ofertën e bashkimit të mësipërm të shoqërive, mund të jetë tek shifrat 30 – 35 l/sek/km2, ndërkohë që moduli i ujit për këtë zonë mund të luhatet në analogji nga të gjitha drejtimet gjeografike të zonës nga 18-24 l/sek/km2, duke mbartur edhe nje risk hidrologjik”,* e për rrjedhojë oferta teknike e bashkimit të shoqërive “Al-Can Hydropower” sh.p.k. & “Fybek” sh.p.k., është e ekzagjeruar dhe përmban të dhëna të rreme, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se:

Nga shqyrtimi i ofertës teknike të paraqitur nga bashkimi i shoqërive “Al-Can Hydropower” sh.p.k. & “Fybek” sh.p.k., rezulton se moduli i ujit për këtë zonë është përlogaritur në 20-25 l/sek/km2.

Gjithashtu, referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimues, vërejmë se nuk është paraqitur asnjë fakt, provë apo argument për të mbështetur pretendimet e ngritura, siç parashikohet në nenin 6, *“Forma dhe Përmbajtja e Ankesës”,* pika 3, gërma “a” të VKM nr. 469, datë 16.06.2010 *“Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e shqyrtimit të ankesave ndaj procedurave të koncesionit apo të vendimeve për përjashtim nga këto procedura”,* dhe *“Për një ndryshim në vendimin nr.27”,* datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”,* ku përcaktohet se:

*“Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me:*

*a) Provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”;*

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga operatori ekonomik ankimues, për të mbështetur të gjitha pretendimet e ngritura, duhej të paraqiteshin prova dokumentare për shkeljet e pretenduara, të cilat do të shqyrtoheshin nga KPP dhe mbi bazën e tyre do të gjykohej ankesa.

Përsa mësipër, pretendimi 2/d i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik bazuar në nenin 24/1, nenin 25 e vijues të Ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006, *“Për Koncesionet”,* VKM nr. 469, datë 16.06.2010 *“Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e shqyrtimit të ankesave ndaj procedurave të koncesionit apo të vendimeve për përjashtim nga këto procedura”,* dhe *“Për një ndryshim në vendimin nr.27”,* date 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”,*

### **V e n d o s i :**

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Kotorri - SL” sh.p.k., për procedurën koncensionare me objekt: *“Për dhënien me koncesion të Hec Malind”,* zhvilluar nga autoriteti kontrakues Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në datë 20.07.2012.

2. Të urdhërojë autoritetin kontraktues, të kualifikojë operatorin ekonomik “Kotorri - SL” sh.p.k., si dhe të skualifikojë bashkimin e përkohshëm të shoqërive “Al-Can Hydropower” sh.p.k. & “Fybek” sh.p.k., nga kjo procedurë koncesionare.
3. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Kotorri - SL” sh.p.k.
4. Autoriteti Kontraktues, Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, të dërgojë një informacion me shkrim brenda afateve ligjore nga marrja dijani, lidhur me zbatimin e vendimit të sipërpërmendur, duke dokumentuar veprimet e kryera;
5. Kundër këtij vendimi, ankimuesi mund të bëjë ankim brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijani, në gjykatën përkatëse për shqyrtimin e mosmarrëveshjes administrative.

**K R Y E T A R I**

**EDI SPAHO**